

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Worqlo sh.p.k

Neni 1
Themelimi

1.1 Ortak Themelues i shoqërisë Worqlo sh.p.k, është:

- Z. Masayuki Kuroda, shtetas japonez, i datëlindjes 04 tetor 1975, nr. pasaporte: TT2218310, me leje qëndrimi shqiptare nr. 286901, nr. leternjoftimi. 839556390 dhe nr. personal. H54004004D, me adrese banimi: Rr. Beqir Luga, Nd. 3, H.1, Nj. Administrative Nr. 2, 1017, Tiranë, Shqipëri.

1.2 Data e Themelimit të Shoqërisë është 03-11-2025. Shoqëria themelohet dhe do të funksionojë bazuar në Ligjin Shqiptar. Ajo do të fitojë personalitetin juridik me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", themelohet një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Worqlo**" **Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Neni 2
Emri

2.1 Emri i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar është Worqlo sh.p.k, këtu e më poshtë e referuar kudo në këtë Akt Themelimi edhe si ("Shoqëria"). Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj, të cilat së bashku me të dhëna të tjera të parashikuara në ligj, do të shoqërojnë çdo dokument që u drejtohet të tretëve.



Neni 3

Forma Ligjore

3.1 Shoqëria "Worqlo", është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "sh.p.k".

Neni 4

Selia

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Durana Tech Park, Rruga Ahmet Zogu, nr. pasurisë 336, ZK 3852, njësia administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, Shqipëri.

Neni 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Neni 6

Shtrirja Territoriale

6.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Ajo ka të drejtë të themelojë ose mbyllë filiale, agjensi, qendra operative, zyra përfaqësimi të çdo lloji, si dhe vende dytësore zhvillimi aktiviteti.

Neni 7

Objekti i Veprimtarisë

7.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është, duke përfshirë por pa u kufizuar në, zhvillimi, implementimi, administrimi dhe shitja e produkteve dhe shërbimeve software për tregun vendas dhe ndërkombëtar. Shoqëria ushtron veprimtari në fushën e platformave konversacionale dhe të inteligjencës artificiale për sipërmarrje, duke ofruar zgjidhje që mundësojnë ndërveprim natyral me sistemet e biznesit, automatizim të proceseve, orkestrim të flukseve të punës, analizë dhe vizualizim të të dhënave, si dhe integrim me sisteme të palëve të treta (CRM, ERP dhe platforma të tjera operative).

Shoqëria zhvillon dhe ofron software enterprise, shërbime teknologjike, module integrimi, njoftime në kohë reale, mekanizma automatizimi dhe platforma cloud ose on-premise të orientuara drejt përmirësimit të proceseve të biznesit. Po ashtu, përfshihet ofrimi i shërbimeve të dizajnit, testimit, mirëmbajtjes, përditësimit dhe suportit teknik për produktet software, si dhe zhvillimi, administrimi dhe licencimi i pronësisë intelektuale të lidhur me këto produkte dhe shërbime. Shoqëria mund të ofrojë shërbimet e saj ndaj klientëve Business-to-Business dhe Business-to-Consumer, si edhe të ndërmarrë çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi që lidhet ose mbështet objektin e sipërpërmendur të veprimtarisë.

Neni 8

Vlera e Kapitalit të Nënshkruar të Shoqërisë

8.1 Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë ka një vlerë totale prej 100,000 LEK (njëqind mijë)

8.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është Z.Masayuki Kuroda. E gjithë vlera e kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë do të shlyhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, brenda një periudhe tremujore nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

8.3 Kapitali i nënshkruar i shoqërisë ndahet gjithësej në një (1) kuotë e cila zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

8.4 Vlera e kontributit të nënshkruar të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, në Kapitalin e nënshkruar të Shoqërisë është gjithësej 100,000 LEK (njëqind mijë)

8.5 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, në bazë të vlerës së kontributit që nënshkruan në kapitalin e shoqërisë, sipas përcaktimeve mësipër në Klauzolën (8.4), do të zotërojë një kuotë me vlerë nominale sipas sa vijon:

- a) Ortaku i Vetëm, Z. Masayuki Kuroda, zotëron një (1) kuotë, me vlerë nominale gjithësej 100,000 LEK (njëqind mijë), e cila përfaqëson 100% të vlerës së kapitalit të regjistruar/nënshkruar të Shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.



Neni 9
Shlyerja e Kontributit nga Ortaku

9.1 Ortaku themelues detyrohet të shlyejë kontributin e tij të nënshkruar në kapitalin e regjistruar/nënshkruar të shoqërisë, sipas vlerës dhe afatit të përcaktuar te Neni (8), më sipër, dhe nëpërmjet dhënies së kontributit në para.

Neni 10
Ortaku i Vetëm

10.1 Meqënëse kapitali i nënshkruar i Shoqërisë zotërohet nga një Ortak i Vetëm, ky i fundit do të ushtrojë të gjithë të drejtat dhe detyrimet e parashikuara për Asamblenë e Përgjithshme në dispozitat e zbatueshme të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

Neni 11
Administratori

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm.

11.1 Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, individ.

11.2 Administratori i Shoqërisë emërohet për kohëzgjatje prej pesë (5) vjet, dhe është i rizgjedhshëm.

11.3 Në lidhje me të drejtat, kompetencat, detyrat dhe kufizimet e funksionit të Administratorit do të zbatohen rregullat e parashikuara në Ligj dhe në Statutin e Shoqërisë.

11.4 Administrator i Shoqërisë për periudhën e parë pesëvjeçare, emërohet:

- Z. Sajli Beqiri, shtetas shqiptar, i datëlindjes 31 tetor 1991, nr. pasaporte: BI2670006 dhe nr. personal. J11031057F, me adresë banimi: Rrugën Arben Minga, Nd.3, H.1, Ap.1, 1001, Tiranë, Shqipëri.



NENI 12
LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13
Dispozita të Fundit

12.1 Ky Akt Themelimi hartohet në tre (3) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Ky Akt Themelimi miratohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm, z. Masayuki Kuroda, sot me datë 03-11-2025, duke autorizuar Administratorin, z. Sajli Beqiri, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

Ortaku i Vetëm

Z. Masayuki Kuroda:

Masayuki Kuroda
